

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtarja Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarës S.M. nga BOLZANO, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP-së. duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr. 60/17 të dt.19.06.2017 dhe të ndryshuar në shqyrtimin fillestar me datën 23.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Ervehe Gashi, të akuzuarës dhe mbrojtësit av. A.J. me datë 23.06.2017 morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

S.M., nga i ati S. e ëma M., e lindur B., e lindur me dt. “ e lindur me ... “ në - Gjerman me vendbanim në BOLZANO, e pamartuar, nëna e një fëmiju, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së varfër ekonomike, pensioniste invalidore, serbe, shtetase e Republikës së Sërbisë, në paraburgim prej datës 29.04.2017 deri me dt.23.06.2017.

ËSHTË FAJTORE

Me dt.29.04.2017 rreth orës 17:55 minuta në pikën kufitare të Vërmicë është hasur se pa autorizim posedon substancën narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1239,8 gr, të paketuare në 5 (pesë) qese najloni e të cilat i kishte vendosur në një valixhe dhe në xhemperin e saj, e në atë momente ishte duke udhëtuar nga Shqipëria për në Kosovë me autobusë të firmës “.... ..” me targa ... - .. -

- kësodore ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve substancave narkotike, psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 8, 9, 10, 21,43, 46, 50, 51, 69, 71, 73, 74, 75, par. 1 pika 1.3, 83, dhe nenet e përmendur më lartë të KP-së

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 500€ (pesëqind) euro, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.04.2017 deri më dt. 23.06.2017. Shumën e mbetur të dënimit me gjobë është e obliguar të paguaj në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë shumën e mbetur të dënimit me gjobë gjykata mund ta zavendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, në mënyrë që për çdo 20€ të dënimit me gjobë do të llogaritet një ditë burg, pra 20 ditë burg

dhe ia shqipton edhe

GJYKIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohë zgjatje prej 2 (dy) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 3 (tre) vite nuk kryen veprë të re penale.

Prej të akuzuarës konfiskohet substanca narkotike e llojit “marihuanë” në një sasi të përgjithshëm prej 1239,8 gr.

Në bazë të nenit 71 par.1 KP, të akuzuare i shqiptohet masa plotësuse **dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës për periudhën kohore prej 10 vite.**

Obligohet e akuzuara që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës sipas llogarisë së gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/I.nr. 60/17 të dt.19.06.2017, kundër të akuzuarës S.M. nga Italiya, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotike, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP-së.

Në shqyrtimin fillestar Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës ka ndryshuar aktakuzën në mënyrë që tani e akuzon për veprën penale nga neni 275 par. 1 KP, duke theksuar se pas analizimit të shkresave të lëndës e sidomos deklaratës të të akuzuarës S.M. dhënë në Prokurori dhe Polici dhe pasi që nga mbrojtja ka pranuar raportin mjekësor nga shërbimi i psikiatrit i territorit të në Itali dr. V.P. , nga e cila shihet se pas çrregullimeve të tjera psikike e akuzuara është edhe e varur nga substanca psikotrope ngase vet abuzon me substanca psikotrope të llojit kanabinoll dhe narkotikëve të tjerë , e nga raporti apo ekzaminimi i substancës së dyshuar të narkotikut të AKF rezulton se substanca e dyshuar për narkotik e cila është gjetur tek e akuzuara në vete përmban kanabis pra tetrahidrokanabinol e cila është e familjes së njëjtë si substancë narkotike me të cilën abuzon e akuzuara , prandaj konsideron se në veprimet e të akuzuarës formohen elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotike, substance psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP-së.

Mbrojtësi i të akuzuarës av. A.J. ka deklaruar se pranimi i fajësisë e të akuzuarës ka mbështetje të plotë në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, posaçërisht në ekspertizën e pranuar nga ana e AKF, andaj propozon që gjykata gjatë vendosjes lidhur

me dënimin të ketë parasysh se e mbrojtura e tij është person i sëmurë, është përdoruese e shumë medikamenteve e në fund edhe e narkotikut , se është nënë e një fëmijë jashtëmartesorë të moshës 5 vjeç i cili nuk e njih as gjuhën në rrethin ku gjendet, si dhe gjendjen e saj të rëndë ekonomike.

E akuzuara pajtohet në tërësi me fjalët e mbrojtësit, duke shtuar se asnjëherë nuk do ta sjellë veten në këtë situatë, problemi më i madhe është që djali përveç saj nuk ka askënd në këtë botë, është e vetëdijshme për gabimin dhe premtori se nuk do ta përsërisë kurrë më .

Në bazë të pranimit të fajësisë të të akuzuarës dhe provave materiale në shkresat e lëndës, është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Ditën kritike më 29.04.2017 rreth orës 17:55 minuta, në pikën kufitare të Vermicë, e akuzuara, e cila ishte duke udhëtuar nga Shqipëria për në Kosovë me autobusë të firmës “....” me targa ... - .. - ... , është hasur se pa autorizim ka poseduar substancën narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1239,8 gr, të paketuar në 5 (pesë) qese najloni, të vendosura në një valixhe dhe në xhemperin e saj.

Duke pasur parasysh se në shqyrtimin fillestar me respekt paraprak të gjithë të drejtave të të akuzuarve, e akuzuara vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së ndryshuar, në bazë të neni 248 KPRK, i cili pranim ka të bëjë si me tërë përshkrimin e ngjarjes nga rrjedhin elementet e veprës penale e cila i vihen në barrë me aktakuzë, ashtu edhe me parashikimin sipas ligjit të veprës së argumentuar dhe me kualitet të tillë sa që jep fakte të cilat janë në kuadër të Ligjit. Në bazë të cekurave gjykata edhe nuk ka administruar provat dhe ka pranuar pranimin e fajësisë së të akuzuarit duke mos gjetur se ekzistojnë provat e papranueshme duke konsideruar se pranimi i fajësisë është vërtetuar me fakte të cilat janë në kuadër të fakteve të tjera të vërtetuara me provat të prezantuara, të cilat prova udhëzojnë në ekzistimin e veprës penale e cila i vihen në barrë me aktakuzë.

Në bazë të gjitha të cekurave më lartë gjykata ka vërtetuar se e akuzuara me dashje ka kryer veprën penale, tek e cila vepër penale dashja ka ekzistuar sepse e akuzuara ka qenë e vetëdijshme se posedimi i substancës paraqet një veprim të kundërligjshëm, me vet faktin se qytetarëve nuk u lejohet posedimi i këtij lloji të substance. Prandaj, në veprimet e saj formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtores dhe dënuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, duke gjetur si rrethanë rënduese se e akuzuara gjatë udhëtimit me autobus, me vete ka bartur substancën narkotike e cila është shpallur si e ndaluar, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, pranimi i fajësisë për veprën penale edhe pse ky element nuk ka ndikuar në zbulimin e ndonjë fakti të rëndësishëm për rastin, se është e gjendjes së varfër ekonomike, pensioniste invalidore, rrethanat familjare –nënë vetushqyese e një fëmijë, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, prandaj gjykata e

ka gjykuar me dënim me gjobë dhe me kusht, duke konsideruar se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPP.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë në bazë të nenit 69 dhe 71 par.1 të KP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
P.nr.66/17 të dt.23.06.2017

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Përkthyesi gjyqësor
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

UDHËZIM JURIDIKË: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykata, Gjykatës së Apelit të Kosovës .